



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 311/15 prot.

Tiranë, më 30.09, 2019

RELACION

Lënda: Mbi raportet e monitorimit për 8-mujorin e vitit 2019

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore", në vijim paraqitet një analizë e përdorimit të fondeve buxhetore për 8-mujorin e vitit 2019, për Institucionin e Komisionerëve Publikë.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor 2019	Buxheti vjetor i rishikuar	Buxheti Plani 8-mujor	Realizimi Fakti 8-mujor/progresiv	Realizimi në %
Shpenzime korente	65,830	65,830	49,780	44,444	89.2%
Shpenzime kapitale	1,500	1,500	1,500	1,040	69.3%
TOTALI	67,330	67,330	51,280	45,484	88.6%

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit për vitin 2019 në shpenzime korente dhe shpenzime kapitale janë 67,330 mijë lekë. Gjatë 8-mujorit të këtij viti, nuk ka rishikim të zërave buxhetor dhe plani 8-mujor progresiv, sipas detajimit mujor dhe rialokimeve të kryera në zërat e shpenzimeve, është 49,780 mijë lekë.

Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për këtë periudhë është në nivelin 89.2% realizim të fondeve buxhetore në shpenzime korente dhe 69.3% realizim në shpenzime kapitale.

Në mënyrë analitike, në formë tabelare, performanca e objektivave dhe e realizimit të shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2019 paraqitet në vijim.

Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor 2019	Buxheti Plani 8-mujor	Realizimi Fakti 8-mujor/progresiv	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	56,100	43,100	42,204	98%
602	Shpenzime për mallra dhe shërbime	9,000	5,950	2,180	37%
606	Trans. për buxhetet fam. dhe individë	730	730	60	8.2%
231	Shpenzime kapitale	1,500	1,500	1,040	69.3%
	TOTALI	67,330	51,280	45,484	88.6%

Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”, buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2019 për këtë zë është 56,100 mijë lekë. Ky buxhet, siç është theksuar në komunikimet me Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, është i pamjaftueshëm për plotësimin e detyrimeve ligjore në fushën e pagave për vitin 2019.

Në komunikimet shkresore me këto institucione, kemi paraqitur argumentet për pamjaftueshmërinë e fondeve për vitin 2019, në këtë artikull buxhetor, duke kërkuar rishikimin e buxhetit.

Për 8-mujorin e parë të vitit 2019, buxheti i planifikuar i shpenzimeve të personelit është 43,100 mijë lekë, bazuar në detajimin mujor, si dhe në avancimin e fondeve, të kryer në muajin gusht, ndërsa realizimi faktik është 42,842 mijë lekë ose 97% e tij. Theksojmë se për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve, buxheti i planifikuar për muajin nëntor nuk i mbulon plotësisht shpenzimet e personelit dhe në muajin dhjetor, siç është paraqitur në detajimin mujor të miratuar në fillim të vitit, ky buxhet është 0 (zero) lekë.

Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, buxheti i miratuar në fillim të vitit për këtë artikull, për vitin 2019, është 9,000 mijë lekë dhe buxheti i planifikuar për 8-mujorin është 5,950 mijë lekë. Në këtë periudhë nuk ka rishikim të buxhetit dhe shpenzimet faktike për mallra dhe shërbime janë 2,180 mijë lekë ose 37 % të buxhetit të planifikuar.

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	1,972	814
2	Shërbime	1,914	1,045
3	Shpenzime transporti	216	12
4	Shpenzime mirëmbajtjeje të zakonshme	328	18
5	Shpenzime të tjera speciale	275	63
6	Shpenzime udhëtimi	1,245	228
	TOTALI	5,950	2,180

Gjatë 8-mujorit janë kryer disa procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël për shpenzime materiale zyre dhe të përgjithshme, kryesisht kancelari, materiale pastrimi dhe me procedura të thjeshtuara blerje materiale dhe shërbime speciale, si ujë të pijshëm për punonjësit, dokumentacion specifik etj. Janë lidhur kontratat dhe kryer shpenzime për shërbimin e parkimit, telefoninë celulare, abonimet në shtypin e ditës etj. Mosrealizimi i fondeve në këtë zë të shpenzimeve, lidhet kryesisht me shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzime postare dhe telefonike, planifikimi i të cilave është bërë në një nivel të përafërt, meqenëse institucioni nuk ka pasur një historik të këtyre shpenzimeve. Në muajt në vijim do të rishikohen nevojat për këto shpenzime dhe do të kryhen rialokime në zëra të tjerë të shpenzimeve, në të cilat janë evidentuar nevoja shtesë, si dhe do të realizohen shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtje të zakonshme. Në muajin shtator kanë nisur procedurat për blerje materiale pastrimi, karburant, kancelari etj., të cilat do të rrisin nivelin e realizimit të fondeve.



Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”, buxheti i miratuar për këtë artikull, për vitin 2019, është 1,500 mijë lekë, po kështu edhe buxheti i planifikuar për 8-mujorin është 1,500 mijë lekë. Realizimi faktik i shpenzimeve në investime në këtë periudhë është 1,040 mijë lekë ose 69.3 % e buxhetit të miratuar në këtë zë. Ky nivel i realizimit të buxhetit në investime lidhet me kohën e nevojshme për realizimin e procedurave të prokurimit, të cilat janë në proces, si dhe me diferencat ndërmjet buxhetit të prokuruar dhe atij të kontraktuar. Në muajin shtator është finalizuar dhe procedura për blerjen e pajisjeve të tjera zyre, e cila do të pasqyrohet në monitorimet për 4-mujorin e fundit të vitit 2019.

Në mënyrë analitike, planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2019 dhe periudhën 8-mujore, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, paraqitet në vijim në formë tabelare, për çdo projekt investimi.

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		Komisioneret Publike				Kodi i Grupit		63	
Programet		Shpenzimet e Institucionit							
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti		
Titulli	Emertimi	i vitit paraardhes Viti 2018	Viti 2019	Plan Fillestar Viti 2019	Plan i Rishikuar Viti 2019	Plani i Periudhes 8 mujore /progresiv	i Periudhes/progresiv	Diferenca	
0001	Programi 03360	46,423	77,931	67,330	67,330	51,280	45,484	-5,796	
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		46,423.00	77,931	67,330.0	67,330.0	51,280.0	45,484.0	-5,796.0	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit					-				
Totali		46,423	77,931	67,330	67,330	51,280	45,484	-5,796	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.9.2019		Data	30.9.2019

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke


Emri i Grupit	Komisionerët Publikë						Kodi i Grupit	63
Programi	Veprimtaria e Komisionerit Publik						Kodi i Programit	03360
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
		i vitit paraardhës	Plan	Viti	Plan Fillestar viti	Plan i Rishikuar	Plani i Periudhes 8	
		Viti 2018	2019	korrent 2019	Viti 2019	muajore /progresiv	Periudhes/progresiv	
600	Paga	34,640	60,991	50,600	50,600	39,100	38,309	-791
601	Sigurime Shoqërore	2,950	5,940	5,500	5,500	4,000	3,895	-105
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4,437	9,500	9,000	9,000	5,950	2,180	-3,770
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme							0
605	Transferta Korente të Huaja					0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			730	730	730	60	-670
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	42,027	76,431	65,830	65,830	49,780	44,444	-5,336
230	Kapitale të Patrupëzuara	120						0
231	Kapitale të Trupëzuara	4,276	1,500	1,500	1,500	1,500	1,039	-461
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	4,396	1,500	1,500	1,500	1,500	1,040	-461
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0
Totali	Shpenzime Kapitale	4,396	1,500	1,500	1,500	1,500	1,040	-461
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti							0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		46,423	77,931	67,330	67,330	51,280	45,484	-5,797


Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.9.2019		Data	30.9.2019

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblidhës i realizimit të treguesve të performances/produkteve të programit"

Emri i Grupit	Komisionerit Publik	83
Programi	Vepërtaria e Komisionerit Publik	3360

Kodi	Emertimi i Treguesit të Performances/Produktit	Njësia matëse	I			II			III			IV			Luhatjet në Koston për Njësi			Komente
			Sasia Faktike (sipas vitit 2019)	Shpenzimet (sipas vitit 2019)	Kosto për Njësi (sipas vitit 2019)	Sasia (sipas planit të vitit 2019)	Shpenzimet (sipas planit të vitit 2019)	Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2019)	Sasia Faktike për 9 muajt e vitit 2019	Shpenzimet Faktike për 9 muajt e vitit 2019	Kosto për Njësi për 9 muajt e vitit 2019	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III				
Produkti 1	Numer Çështjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisionerët Publikë brenda afatëve ligjore	nr. Çështjesh	77	42,027	546	120	65,830	549	120	65,830	549	92	44,444	483	-11%	-12%	-12%
Produkti 2	Pajisje komp/mobile/pajisje zyre	sete pune	36	4,396	122	11	1,500	136	11	1,500	136	8	1,040	130	6%	-5%	-5%
	Totali			46,423	668	131	67,330	685	131	67,330	685	100	45,484	613				0



Nepunësi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati
	Firma	
	Data	30.9.2019

Kordinatori i GMS/Nepunësi Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma	
	Data	30.9.2019

ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikave se programit"

Periudha e Raportimit: 8 mujorin 2019


Kodi i Programit	3360	Emertimi i programit:						Komente
Qellimi 1	Procesi i Rivleresimit te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise ka per qellim garantimin e e funksionimit te shtetit te se drejtes, pavaresine e sistemit te drejtesise si dhe rikthimin e besimit te publikut tek institucionet e ketij sistemi	Veprimtaria e komisionerit Publik						
Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2018	Niveli i planifikuar ne vitin 2019	Niveli i rishikuar per 8 mujorin e vitit 2019	Niveli faktik per 8 mujorin e vitit 2019	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit
Objektivi 1.1	Mbrojtja e interesit publik gjate kryerjes se procesit te rivleresimit, respektimi i parimit te paanesise dhe pavaresise, procesit te regullt ligjor, transparences dhe frymes se bashkepunimit ndermjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe institucioneve te tjera."							
	Numer Çeshjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	A	Shqyrtim i vendimeve te njoftuara nga KPK	77	120	120	92	77%

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.9.2019		Data	30.9.2019

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2019	Realizimi Progrosiv nga fillimi i vitit 2019	Realizimi për periudhën e raportimit vjetor	Realizimi Progrosiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	650	2019	2019	38	650	382	344	382	Eshte ne proces finalizimi procedura per pajisje zyre.
M630013	Pajisje kompjuterike	850					658	658	658	
TOTALI		1,500			38	650	1,040	1,002	1,040	-

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	30.9.2019		Data	30.9.2019

